



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. 88/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 1, TË
MARRËVESHJES SË HUAS TË DATËS 31.12.2012, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
(EBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË
SË DIGËS NË HIDROCENTRALIN E KOMANIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.
103/2013**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr.1, e marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në Hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 22.11.2018